



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1076/11 Prot.

Tiranë, më 25.2.2026

**Lënda:** Kthim përgjigje mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtar

**Z. Besnik DERVISHI**  
Komisioner  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
*Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë*

Për dijëni:

**Qëndrës "RES PUBLICA"**  
*Blv. "Gjergj Fishta", nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë*

I nderuar Z. Dervishi,

Në vijim të shkresës suaj me nr. 518/1 prot., datë 19.02.2026 protokolluar me tonën nr.1076 prot., datë 23.02.2026, mbi ankesën e Qëndrës "Res Publica" për mosdhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtar, ju informojmë si më poshtë vijon:

Bazuar në mandatin dhe përgjegjësitë institucionale, Ministria e Mjedisit (më herët Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) ka marrë pjesë në aktivitete, konferenca dhe projekte ndërkombëtare që lidhen drejtpërdrejt me fushën e mjedisit, klimës, zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit (përfshirë panairë dhe aktivitete promovuese), si dhe në kuadër të ndjekjes së proceseve të integritit evropian. Këto angazhime burojnë nga detyrimet ligjore dhe ndërkombëtare të institucionit dhe janë pjesë përbërëse e ushtrimit normal të funksioneve të tij.

Sa i takon zërave të shpenzimeve për shërbimin e akomodimit dhe biletave të avionit për udhëtimet ndërkombëtare, theksojmë se çdo procedurë është ndjekur me rigorozitet të plotë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, menaxhimin financiar dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Procedurat janë zhvilluar në mënyrë transparente përmes sistemit elektronik të prokurimit publik dhe sistemit të pagesave, duke garantuar gjurmueshmëri, kontroll dhe akses publik sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Deri në datë 25.09.2025 institucioni ka përfshirë në strukturën e tij dy sektorë të rëndësishëm, Turizmin dhe Mjedisin, dhe më pas me riorganizimin e institucioneve qendrore, institucioni ka vijuar funksionimin vetëm me fushën e Mjedisit,

Për vitin 2025, konkretisht për periudhën 01 Janar 2026 – 31 Dhjetor 2026 rezulton se:

- shpenzimet totale për shërbimin e biletave të avionit për udhëtime jashtë vendit janë në vlerën 5,502,139 lekë,
- shpenzimet totale për shërbimin e akomodimit në vlerën totale 11,672,239 lekë.

Destinacionet kryesore ku janë realizuar udhëtimet gjatë kësaj periudhe kanë qenë: Spanjë, Gjermani, Belgjikë, Azerbajxhan, Austri, Francë, Egjipt, Greqi dhe Itali, në funksion të përmbushjes së angazhimeve institucionale dhe përfaqësimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë në aktivitetet përkatëse ndërkombëtare.

Duke Ju falënderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Ledina BEQIRAJ AGALLIU**

